



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 20.09.2012

Nr.0204-997

Naim Baftiu
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Financave

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar dy Vendime lokale:

- **Vendimin për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;**
- **Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme, 01. Nr.110-2250**

Vendime të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK të Prishtinës, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, ju si ministri Kryesuese e Komisionit, po ju përcjellim për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë këto Vendime lokale.

Bashkangjitur gjeni Vendimet e lartshënuara nga Komuna e Prishtinës.

Me respekt,

Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Lumnije Hetemi, MF;
Fetije Begolli, MAPL;
Bedrije Halili, MF;
Jak Ndreca, MF;
Driton Xhafa, MAPL;
Arkivës së MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristina, Dana: 21.09.2012
Br.0204-997

Naim Baftiu
Gjeneralni Sekretar
Ministriaarstvo Finansija

Predmet: Proparatni dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave je primilo dve lokalne Odluke:

- Odluka o dopuni Uredbe o tarifama, zaduženja i opštinske kazne;
- Odluka za izmenu i dopunu Uredbe za porez na nepokrenu imovinu, 01. Br.110-2250

Odluke usvojene od Skupštine Opštine Priština i potpisane od Predsedavajućeg SO Pristina, u cilju procenjivanja zakonitosti.

Na osnovu Odluke Vlade br. 2/119 od dt. 07.04.2010 o formiranju komisija za razmatranje lokalnih akata, vi kao ministarstvo Predsedavajuće komisije, dostavljamo vam na razmatranje i procenjivan je zakonitosti ovih lokalnih Odluka .

U prilogu ćete naći gore nevedene Odluke iz Opštine Priština.

S poštovanjem,


Besnik Osmani,
Generalni Sekretar,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave

Kopija: Lumnije Hetemi, MF;
Fetije Begolli, MALS-a;
Bedrije Halili, MF;
Jak Ndreca, MF;
Driton Xhafa, MALS-a;
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 049 për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të dispozitave të nenit 33, paragrafi 33.1, pika a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30.08.2012, miratoi këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

I.

MIRATOHET Vendimi për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale, 01. nr. 110 - 2782, të dt. 2.12.2011.

II.

Në nenin 6, pas pikës c, shtohet pika d, me këtë përmbajtje:

"Nga pagesa e rentës për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, lirohen investitorët, të cilët investojnë në projekte të rëndësisë së veçantë për Komunën dhe projekte humanitare që nuk kanë karakter profitabil, të cilat investime, pas kalimit të afatit të caktuar sipas kontratës, mbesin në pronësi të Komunës. Vendimin për lirim nga pagesa e rentës e merr Kryetari i Komunës".

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës.


Drejtoritë e Komunës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara për zbatimin e këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyh në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr. 110-31599, më 30. 08. 2012



KRYETARI I KUVENDIT
Sami Nisani, ecc i dipl.

Faqe 1 nga 2



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 049 për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të dispozitave të nenit 2 të Ligjit nr. 04/ L - 100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 2004 për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 14/2012), të dispozitave të nenit 33, paragrafi 33.1, pika a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30.08.2012, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR TATIMIN NË
PRONËN E PALUAJTSHME, 01. NR. 110 - 2250 TË DT. 5.10.2011

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme, 01. Nr. 110 - 2250 të dt. 5.10.2011.

II.

Në nenin 1, paragrafi 1.2, pas fjalëve menaxhimin e financave publike shtohen edhe fjalët:
" dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal".

III.

Neni 5, ndryshohen dhe plotësohet duke u riformuluar si në vijim:

5.1 Kuvendi i Komunës i cakton tarifat tatimore për pronën, në bazë vjetore, në shkallën prej 0.15 % deri 0.17 % të vlerës së pronës në treg.

5.2 Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës:

- a) Pronë e nevojshme për qëllime banimi: prona e paluajtshme, e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore të banimit, ku përfshihen: shtëpitë, banesat dhe ndërtesat e ngjashme0.15 %;
- b) Pronë e banuar: prona e cila shfrytëzohet ose mbahet për banimin e njerëzve, ku përfshihen: toka, garazhet, hapësirat e parkimit ose ndërtesat e tjera të ngjashme jokomerciale.....0.15 %;
- c) Pronë komerciale: prona që shfrytëzohet ose përdoret për qëllime biznesi, për shembull për ndonjë qëllim komercial ose biznesi, për shitje me pakicë, për shërbime rekreacioni, për qëllime artistike ose sportive, për arsim privat ose për qëllime mjekësore private.....0.17 %;
- d) Fusha sportive.....0.17%;
- e) Pronë industriale: prona e cila shfrytëzohet për produkte artikujsh, për prodhim, për punim ose deponim të mallrave, duke përfshirë fabrikat, depot, punëtoritë dhe objektet e tjera të ngjashme.....0.16 %;
- f) Pronë bujqësore: toka dhe ndërtesat, të cilat shfrytëzohen për qëllime bujqësore..... 0.15%

5.3 Tarifat e tatimit të caktuar për pronën në kategoritë 5.2 (c) dhe 5.2 (d), nuk do të jenë më të mëdha se 2.5 herë të lartësisë së tarifës së tatimit për pronën në kategorinë 5.2 (b).

5.4 Madhësia e pronës shprehet në metër katror (m^2), e kalkuluar vetëm nga matjet e mureve të jashtme, duke llogaritur edhe metrat katror të etazheve(kateve). Për katin nën kulm, sipërfaqja llogaritet për 50% më pak nga sipërfaqja e katit të plotë.

IV.

Neni 5, paragrafi 5.3 pas fjalëve sipërfaqja e katit të plotë duhet të jetë:

“Komuna e Prishtinës ndahet në gjashtë zona tatimore, prej të cilave katër zona (I,II,III dhe IV) janë urbane dhe dy zona janë rurale (V dhe VI). Zonat urbane I,II dhe III ndahen më tutje në kategorin e parë dhe të dytë”.

V.

Pas caktimit të fshatarave të Zona e VI, teksti i mëtejshëm ndryshon dhe plotësohet duke u riformular si në vijim:

Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe shprehet në € për $1 m^2$, si vijon:

Zona e I

Kategoria parë

Pronat me destinim banimi dhe rezidencial : banesë 490
shtëpi650

“6.1 Institucionet dhe organizatat e cekura më poshtë, do të lirohen nga tatimi për pronën që e posedojnë ose e shfrytëzojnë:

- a) Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- b) Kombet e Bashkuara ose çdo organ i saj, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuar dhe të Bashkimit Evropian;
- c) Forcat shumëkombëshe në Republikën e Kosovës (KFOR, ICO dhe EULEX);
- d) Përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat e akredituara në shtetin e Kosovës, rregullimi i të cilave bëhet me marrëveshje të reciprocitetit mes shteteve, zyrat e huaja të ndërlidhjes, agjencitë qeveritare, organizatat ndërqeveritare ose agjencitë e huaja donatore që ofrojnë ndihmë humanitare, punë rindërtimi, administrim civil ose ndihmë teknike brenda Kosovës;
- e) Organizatat joqeveritare me status të përfitimit të ndërsjellë publik, në përputhje me Ligjin për asocimin e organizatave joqeveritare në Kosovë;
- f) Institucionet fetare, të përcaktuara me Ligj, prona e të cilave mbahet dhe shfrytëzohet vetëm për qëllime fetare dhe
- g) Objektet të cilat me ligj janë shpallur monumente të mbrojtura kulturore e historike.

6.2. Lirimi nga tatimi, sipas nenit 6.1, nuk vlen kur:

- a) prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave ose
- b) prona e zotëruar ose e shfrytëzuar nga një organizatë joqeveritare me status të përfitimit publik, nuk shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllime të përfitimit publik”.

VII.

Neni 11, paragrafi 1, ndryshon dhe në te thuhet:

“11.1 Vlerësimi i pronës së paluajtshme nga ana e Komunës bazohet në Udhëzimin administrativ përkatës që e nxjerr Ministria e Financave, me të cilin parashtrohen standardet unike të vlerësimit, sipas të cilave Komuna e vendos vlerën e pronës në treg. Standardet përfshijnë variablet relevante të vlerësimit, siç janë vlera në pajtim me kontratën e shitjes së pronës së paluajtshme, e vlerësuar nga organi kompetent, të ardhurat të cilat krijohen nga prona, shpenzimet e ndërtimit, vendi, madhësia dhe gjendja e pronës. Standardet do të bazohen në një vlerësim të përgjithshëm, pos rasteve kur prona shfrytëzohet për qëllime të veçanta ose për pronë unike”.

VIII.

Në nenin 13, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2 dhe paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

“13.2 Pagesa e tatimit në pronë duhet të bëhet në tërësi nëse kërkohet të bëhet transfer i pronës apo ndërrim i pronarit, qoftë ai tatimpagues i ligjshëm, shfrytëzues i ligjshëm apo shfrytëzues tjetër”.

“13.3 Pagesa e tatimit për pronat e ish – ndërmarrjeve shoqërore që janë privatizuar, duhet të bëhet sipas llogaritjeve në përputhshmëri me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme,

duke përfshirë këtu edhe llogaritjen e dënimit dhe kamatës sipas dispozitave të nenit 18 dhe 19 të ligjit”.

IX.

Neni 20, ndryshon dhe në të thuhet:

1. Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi komunal, mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimi të Vendimit nga Bordi Komunal:

1.1 deri më 30 nëntor 2012 në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave;
1.2 nga dt. 1 dhjetor 2012 në Divizionin Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

2. Nëse Bordi komunal nuk ka marr vendimin brenda 60 ditëve nga dita në të cilën ankesa është dorëzuar, tatimpaguesi mund të ushtrojë ankesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në organet e caktuara në paragrafin të këtij neni sipas kompetencës së tyre.

3. Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, mund të ankohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 60 ditëve nga dt. e pranimi të vendimit, deri më 30.11.2012.

4. Nga dt. 1 dhjetor 2012, gjykatë kompetente për të pranuar ankesa kundër Vendimit të lëshuar nga organi kompetente për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, është Gjykata Themelore në Prishtinë.

5. Në procedurën e ankesave, për çështje që nuk janë paraparë në këtë ligj, gjen zbatim Ligji për Administratën tatimore në fuqi.

X.

Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, gjen zbatim Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme, si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë tatimin në pronën e paluajtshme.

XI

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr.110-31584, më 30.08.2012



Faqe 6 nga 7